



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:274540  
Datë: 26.12.2024  
Numri i dokumentit: 06651370

**C-IV-14-5568**

*Parashtruesi i kërkesës*

**H K** nga Prishtina, përfaqësuar nga avokatit **B I**, Prishtinë

*kundër*

*Pala kundërshtare*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) ( NSH “Ingeniering” në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 26 dhjetor 2024, lëshon këtë:

**AKTGJYKIM**

- 1. Refuzohet kërkesa e përfaqësuesit të ankuesit mbi bashkimin e lëndëve.**
- 2. Kërkesa për rishikimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN129-0055 datë 8 maj 2014 refuzohet si i pabazuar.**
- 3. Kërkesa për rishikimin e Vendimit PRN129-0054 datë 27 maj 2014 aprovohet si pjesërisht e bazuar.**
- 4. Shfuqizohet Aktvendimi i Autoritetit të likuidimit PRN129-0054 datë 27 maj 2014.**
- 5. Obligohet Autoriteti i Likuidimit i AKP që ankuesit, H K në emër të kompensimit për paga të papaguara, ti paguhet shuma prej 4,177.00 Euro dhe në emër të interesit ligjor shumë prej 417.70 Euro si dhe në emër të taksës gjyqësore shuma prej 30.00 Euro.**
- 6. Pjesa tjetër e mbetur e kompensimit për paga të papaguara në shumë prej 1,296.68 Euro refuzohet si e pabazuar.**
- 7. Obligohet Autoriteti i Likuidimit që përfaqësuesit të ankuesit, avokat B I në emër të përpilimit të kërkesës për rishikim – ankesës dhe përgjigjes ndaj përgjigjes së AKP të ja paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 208.00 Euro.**
- 8. Nuk caktohen shpenzime tjera.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 19 qershor 2014, fillimisht u parashtrua një kërkesë grupore e 26 (dy gjashtë) punëtorëve, të NSH, përfaqësuar nga avokati B I kërkesë kjo grupore mbi rishikim e Vendimeve të AL të secilit ankues veç e veç.

Me anë të kësaj kërkesë, grupore, është kërkuar rishikimi i Vendimeve të AL, lidhur me kompensimin për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratave të punës.

Nga zyra e regjistrarit, kërkesa e ankuesit, H K është regjistruar si kërkesë e veçantë dhe me numër të lëndës C-IV-14-5568.

Ankuesi fillimisht me kërkesën grupore, të emërtuar ankesë, kërkoj rishikimin e Vendimeve të Autoritetit të Likuidimit ( AL), si në vijim:

- a. PRN129-0055 datë 8 maj 2014 ( në tekstin e mëtutjeshëm VENDIMI 1) sipas të cilit Vendim ankuesit i është refuzuar kërkesa për kompensimin e tre (3) pagave të papaguara, në shumë prej 1,170.00 ( një një shtatë zero) Euro, dhe
- b. PRN129-0054 datë 27 maj 2014, ( në tekstin e mëtutjeshëm VENDIMI 2) sipas të cilit Vendim i është refuzuar kërkesa për kompensimin e pagave të papaguara, për periudhë të pacaktuar, në shumë prej 5,446.68 (pesë katër katër gjashtë gjashtë tetë) Euro,

që të dy këto kërkesa ndaj NSH “Ingeniering” (në likuidim).

Ankesës grupore, i është bashkangjitur një listë e pagave të 25 (dy pesë) ankuesve, e përpiluar nga vetë përfaqësuesi i ankuesve.

Ankuesi tani me një ankesë të veçantë, e datuar 13 qershor 2014, kundërshtoj vetëm se VENDIMIN 1, mbi kërkesën mbi tre (3) pagave të papaguara.

Ankuesi pohoi se pas privatizimi të NSH, e privatizuar me datë 27 mars 2007, me anë të njoftimit së Agjencisë, duke filluar që nga data 14 janar 2009, i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe se me kohë ka parashtruar kërkesën pranë AL.

Ankuesi pohon të drejtën e tij duke ju referuar dispozitave ligjore si, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27 dhe 2005/48 si dhe Ligjin e punës nr. 03/L-212 të vitit 2010, Ligjit të AKP dhe Shtojcës së Ligjit për AKP.

Përfaqësuesi i ankuesve kërkoj që të gjitha kërkesat –ankesat e punëtorëve ndaj vendimeve të AL të bashkohen në një të vetme, duke ju referuar Ligjit për DHPGJS ( Ligjit nr. 04-033).

Ankuesi tutje pohon se ishte i përfshirë në listën e punëtorëve të NSH me të drejtë pjesëmarrje në pjesën e 20% nga privatizimi i NSH. Si i përfshirë në listë konsideron se i ka plotësuar kushtet e parapara sipas nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 e plotësuar dhe ndryshuar.

Përfaqësuesi i ankuesve kërkon gjithashtu që të gjitha kërkesat –ankesat e punëtorëve ndaj vendimeve të AL të bashkohen në një të vetme, duke ju referuar Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut 2008/6.

Ankuesi kundërshtoj pretendimet e AL mbi parashkrimin e kërkesave duke konsideruar se Ligjit për punën e bashkuar nuk është ligj i aplikueshëm sepse i njëjti me hyrjen në fuqi të Ligjit për ndërmarrjet ( gazeta zyrtare nr. 77/88) me plotësime dhe ndryshime ka shfuqizuar Ligjin për punën e bashkuar.

Ankuesi në vijim i referohet Rregulloreve të UNMIK-ut 2001/27 dhe 2005/48, Ligjit të AKP dhe Ligjit të punës në Kosovë, me të cilat dispozita ligjore do ti takonte e drejta në paga.

Ankuesi gjithashtu konsideron se pasi që vetë procesi i likuidimit, të NSH, ka filluar me një vonesë prej 5 apo 10 viteve, atëherë është përgjegjësi e vetë Agjencisë e jo edhe ankuesit.

Nga të gjitha arsyet u propozua që kërkesa mbi tre (3) pagat, në shumën e kërkuar prej 1,170.00 (një një shtatë zero) Euro duke përfshirë edhe kamatën ligjore prej 10%, të aprovohet.

Kërkesës për rishikim-kundërshtimit i janë bashkangjitur:

- Kopja e Autorizimit për përfaqësuesin,
- Kopja e librezës së punës,
- Kopja e Vërtetimit, lëshuar nga NSH, me të cilin shihet se ankuesi pranë NSH ishte i punësuar nga data 2 tetor 1986 e gjer me 14 janar 2009 (VËRTETIMI 1),
- Kopja e VENDIMI 1, dhe
- Kopja e Njoftimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës datë 14 janar 2009 (në tekstin në vijim NJOFTIMI).

Me 21 prill 2020, përfaqësuesi i ankuesit parashtroj një parashtresë për rregullimin dhe plotësimin e kërkesës për rishikim-ankesës.

Tani ankuesi me anë të kësaj parashtrese, atakoj Vendimin e AL PRN129-0053 datë 15 maj 2014, vendim ky i cili nuk është objekt shqyrtimi respektivisht nuk është atakuar sipas kërkesës, inicuese, për rishikim-ankesës së ankuesit.

Sipas këtij Vendimi të AL, PRN129-0053 datë 15 maj 2014, ankuesit i është refuzuar kërkesa për kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës, në shumë prej 21,645.00 (dy një gjashtë katër pesë) Euro.

Me anë të kësaj parashtrese, pohohet se ankuesi ishte në marrëdhënie pune pranë NSH për 23 vite, duke llogaritur nga data 2 tetor 1986 e gjer 14 janar 2009, e që sipas Ligjit të punës do të duhej ti takonin 6 (gjashtë) paga.

Sikurse edhe me anë të kërkesës për rishikim, ankuesi i referohet zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore mbi parashkrimin duke ju referuar Ligjit për ndërmarrjet – LND (gazeta zyrtare nr. 77/88), praktikës gjyqësore dhe vendimeve të saj, Ligjit të punës të KSA të Kosovës, Rregullores së UNMIK-ut mbi Ligjin e punës në Kosovë, Ligjit mbi trustin pensional, Ligjit mbi pagat në Kosovë si dhe Konventës Evropiane mbi liritë dhe të drejtat e njeriut në këtë drejtin edhe Vendimeve të Gjykatës Evropiane mbi liritë dhe të drejtave të njeriut. Ankuesi sa i përket kamatave ligjore, kamatë vonesave i referohet dispozitave ligjore të Ligjit të AKP, Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve si dhe sa i përket shpenzimeve gjyqësore Ligjit për procedurën kontestimore. Nga gjitha arsyet i propozoj gjykatës, që kërkesën kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës në shumë totale prej 2,502.00 të aprovohet duke përfshirë edhe kamatën ligjore prej 8%.

Përfaqësuesi i ankuesit kërkoj kompensimin e shpenzimeve gjyqësore në shumë prej 208.00 Euro, dhe atë në emër të kërkesës për rishikim dhe përgjigjes ndaj përgjigjes së AKP.

Kësaj parashtrese i janë bashkangjitur:

- Kopja e listës së pagave të punëtorëve të NSH për muajin dhjetor 2006. Sipas kësaj liste shihet i përfshirë edhe ankuesi, sipas numrit rendor 24, me lartësi page prej 388.00 (tre tetë tetë) Euro,
- Kopja e Njoftimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, lëshuar nga AKP, drejtuar ankuesit,

- Kopja e Vërtetimit, lëshuar nga NSH, me të cilin shihet se ankuesi pranë NSH ishte i punësuar nga data 2 tetor 1986 e gjer me 14 janar 2009,
- Kopjen e Autorizimit për përfaqësuesin, dhe
- Kopjen e Vendimit të AL, PRN129-0053 datë 15 maj 2014.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 16 shkurt 2023 parashtroj përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. AKP fillimisht pohon se AL me rastin e vendosjes ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP tutje pohon se kërkesa për rishikim-ankesa, nuk përmban argumentet e saj ligjore ashtu siç edhe parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP dhe si rrjedhim ankesa është e pabazuar. AKP përfundimisht pohon se kërkesat e ankuesit, sipas Vendimeve të AL, janë të pabazuara, dhe se i konsideron si të parashkruara në pajtim me 608 të Ligjit për punën e bashkuar. AKP i referohet vendimeve të DHPGJS. Lidhur me parashkrimin AKP i referohet veçmas po ashtu edhe VENDIMIT 1 dhe Vendimit të AL PRN129-0053. Nga gjitha arsyet AKP propozoj që kërkesa për rishikim të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Përgjigjes i janë bashkangjitur:

- Kopjet e Vendimit të AL PRN129-0053 datë 15 maj 2014 dhe VENDIMI 1, si dhe
- Kopja e Vendimit për emërimin e anëtarëve të AL.

Duke vepruar sipas urdhrin të gjykatës, përfaqësuesi i ankuesit me 29 mars 2023 parashtroj përgjigjen ndaj përgjigjes së AKP.

Përfaqësuesi i ankuesit mbeti në tërësi si pranë kërkesës për rishikim ashtu që tani, siç thekson sqaroj për gjykatën se objekt shqyrtimi sipas kësaj lënde janë VENDIMI 1 dhe VENDIMI 2. Ankuesi kundërshtoj përgjigjen e AKP. Përfaqësuesi i ankuesit mbeti pranë kërkesës sa i përket pagave të papaguara, në shumë prej 1,170.00 ( një një shtatë zero) Euro dhe kërkesës për kompensimin e pagave të papaguara, për periudhë të pacaktuar, në shumë prej 5,446.68 (pesë katër katër gjashtë gjashtë tetë) Euro përfshirë edhe kamatën ligjore.

Përfaqësuesi i ankuesit, edhe me këtë përgjigje mbeti pranë pohimeve sikurse me kërkesën për rishikim-ankesës, duke ju referuar NJOFTIMIT, të drejtës së ankuesit në paga sipas Ligjit për punën, kundërshtimeve rreth parashkrimit të kërkesës dhe praktikës gjyqësore sipas Vendimeve të kësaj gjykate.

Përfaqësuesi i ankuesit kërkoj kompensimin e shpenzimeve gjyqësore në shumë totale prej, 208.00 Euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumë prej 62.00 (gjashtë dy) Euro.

Përgjigjes i janë bashkangjitur:

- Kopja e librezës së punës,
- Kopja e kërkesës grupore-ankesës, datë 13 qershor 2014,
- Kopjet e Vendimeve – VENDIMI 1 dhe VENDIMI 2,
- Kopjen e NJOFTIMIT, dhe
- Kopja e Vërtetimit, lëshuar nga NSH me datë 31 dhjetor 2008, në të cilën thuhet se ankuesit i janë mbetur obligim për paga të papaguara shuma prej 4,177.00 ( katër një shtatë shtatë) Euro ( në tekstin në vijim VËRTETIMI 2).

## Arsyetimi Ligjor

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr.06/L-086) në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

### Kërkesa për bashkim të lëndëve

Kërkesa për rishikim-ankesat e 26 (dy gjashtë) ankuesve pranë DHPGJS janë regjistruar si kërkesa –ankesa individuale dhe sipas regjistrimit të gjykatës kërkesa e çdo ankuesi përmban numër individual.. Këto lëndë tani më janë në fazë të avancuar të procedurës të zhvilluar nga gjyqtarët e çështjes.

Andaj nga këto arsye, gjykata konsideron se nuk janë plotësuar kushtet ligjore mbi bashkimin e lëndëve, ashtu siç parashihet sipas nenit 41.1 i Ligjit për DHPGJS (ligji nr. 06/L-086).

Për më tepër neni si më lartë i cituar i Ligjit për DHPGJS lejon edhe ndarjen e lëndës. Aty thuhet se: “*para nxjerrjes së një Aktgjykimi për të gjitha kërkesat/ ankesat që do të bashkohen, mund të ndahet çfarëdo kërkesë/ankese për të cilën nuk është nxjerrë një Aktgjykim.*” Dispozitë e ngjashme ishte edhe dispozita e nenit 33.1 të Ligjit të mëparshëm të DHPGJS (ligji nr. 04/L-033) ligj ky në fuqi me rastin e parashtrimit të kërkesës për rishikim-ankesës.

Nga gjitha arsyet gjykata vendosi si në pikën 1 të dispozitivit.

### Kërkesat për rishikimin e Vendimeve PRN129-0055 datë 8 maj 2014 dhe PRN129-0054 datë 27 maj 2014

Ankuesi, përfundimisht me përgjigjen e tij ndaj përgjigjes së AKP mbeti, sikurse me kërkesën fillestare për rishikim-ankesë, me kërkesë për rishikimin e Vendimeve të AL PRN129-0055 datë 8 maj 2014 dhe PRN129-0054 datë 27 maj 2014.

### Kërkesa për rishikimin e Vendimit të AL PRN129-0055 datë 8 maj 2014

Kërkesa konsiderohet si e pabazuar.

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankuesit, që në parashtrimit e tij me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e saj. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesi, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Nga dispozita e cekur si më lartë, është obligim i ankuesit që të dëshmoj detyrimet ndaj tij, mbi mos pagesën e të ardhurave personale, tre (3) pagave të mbetura të pa-paguara.

Kopja e listës së pagave të punëtorëve të NSH për muajin dhjetor 2006, e parashtruar nga ankuesi, nuk paraqet dëshmi të mjaftueshme me të cilin ankuesit do ti njihej e drejta në tre (3) pagat e kërkuara.

Lidhur me pagat e papaguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe

likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 dhe 1.6.2 parashihet:

- a. përmbushja e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person, si dhe
- b. drejta në kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në .

Tutje sipas nenit 40 paragrafi 1.7, të shtojcës së Ligjit për AKP, parashihet përmbushja e kërkesave siç janë: “kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë”.

Nga dispozitat e lartëcekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën në paga respektivisht dëmshpërblim nëse:

- a. pagat e punonjësit, në këtë rast ankuesit, nuk janë paguar.

Ankuesi nuk ka dëshmuar të drejtën e tij mbi 3 (pagat) pagat ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.1, si dhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS.

VËRTETIMI 2 i parashtruar nga ankuesi, në rastin konkret, nuk paraqet dëshmi mbi 3 (tre) pagat që do ti takonin, ashtu siç parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.1.

Nga gjitha arsyet gjykata vendosi si në pikën 2 të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

#### *Kërkesa për rishikimin e Vendimit të AL PRN129-0054 datë 27 maj 2014*

Kërkesa për rishikim konsiderohet si pjesërisht e bazuar.

Gjykata konsideron se lidhur me pagat e papaguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 parashihet e drejta në kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në .

Tutje sipas nenit 40 paragrafi 1.7, të shtojcës së Ligjit për AKP, parashihet përmbushja e kërkesave siç janë: “kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë”.

Nga dispozitat e lartëcekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën dëmshpërblim nëse:

- a. Kontrata mbi punën i është ndërprerë para afatit të përfundimit, të saj;
- b. Pushimi nga puna ka ardhur si pasojë i Vendimit të AL, dhe

- c. Ndonjë veprim nga Agjencia, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Në këtë rast ankuesi ka ofruar dëshmi relevante që dëshmojnë se ka qenë punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e vendimit/veprimit të AKP.

VËRTETIMI 2 dhe NJOFTIMI, argumentojnë faktin mbi pagat e papaguara, ndaj ankuesit, për vitin 2007 dhe vitin 2008 dhe se i njëjti ka qenë punëtor aktiv respektivisht punëtor i regjistruar i NSH-së gjer me datën e privatizimit, 14 janar 2009.

AKP, asnjëherë, nuk e ka kundërshtuar shumën e kërkuar nga ana e ankuesit, respektivisht nuk e ka argumentuar të kundërtën me çka ankuesit do ti mohojë drejta në kompensimin e pagave. AKP faktet nuk i kontestuar (*positive litis contestation*) e për më tepër provat e parashtruara, siç u cekën më lart, kanë dëshmuar, vërtetësinë e pohimeve të palës së kundërt, në këtë rast ankuesit. Kjo shihet nga fakti se AKP, edhe si një nga arsyet e vetme mbi refuzimin e kërkesës e potencon çështjen e parashkrimit.

Gjykata me rastin e vendosjes mbi shumën e aprovuar, në lartësi prej 4,177.00 ( katër një shtatë shtatë) Euro, vendimin e saj e mbështeti nga VËRTETIMI 2 i parashtruar nga ankuesi, gjersa shumën e mbetur në lartësi prej 1,296.68 (një dy nëntë gjashtë gjashtë tetë) Euro e refuzoj në mungesë provash ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS.

Nga gjitha arsyet e dhëna si më lartë gjykata konsideron se ankuesi, lidhur me shumën e aprovuar prej 4,177.00 ( katër një shtatë shtatë) Euro, ka arritur që të dëshmojë të drejtën në kompensim, dhe se i takon e drejta në paga, siç parashihet sipas nenit 40 paragrafi 1.7, të Shtojcës së Ligjit për AKP.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me kamatën ligjore, vepron në pajtim me nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit për AKP.

Nga të gjitha arsyet u vendos si në pikën 3, 4, 5 dhe 6 të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

#### Çështja e parashkrimit të kërkesave të ankuesit

VËRTETIMI 2 dhe NJOFTIMI, argumentojnë faktin se i njëjti ka qenë punëtor aktiv i NSH-së gjer me datën e privatizimit të saj, 14 janar 2009.

AL me anë të vendimit të saj si dhe AKP në përgjigje ndaj rastit të ngjashëm, lidhur me parashkrimin i referohet nenit 608 pika 1 të Ligjit për punën e bashkuar - LPB ( gazeta zyrtare e RSFJ 53/76).

Këtë konkludim të AKP-së gjykata e konsideron si aplikim të gabuar të dispozitave ligjore, nga arsyet si në vijim.

Tutje lidhur me parashkrimin e kërkesave, sipas nenit 608 në paragrafin 2 të LPB thuhet:

*“Në parashkrimin e kërkesave sipas pikes 1 të këtij neni në mënyrë të ngjashme aplikohen rregullat e përgjithshme mbi parashkrimin e kërkesave, në rastet kur ato kërkesa parashkruhen për tri vite”.*

Mëtutje sipas nenit 370, të po të njëjtit ligj, thuhet:

“ Rregullat për parashkrimin nuk zbatohen në rastet kur me ligj janë caktuar afatet brenda të cilave duhet të paraqitet padia ose të kryhet një veprim, nën kërcënim të humbjes së të drejtave”.

Dispozitat e lartë cekura të LMD, ishin në aplikim në kohën e marrjes së njoftimit.

Dispozita identike parashihen edhe sipas Ligjit të Kosovës (nr. 04/L-077) për marrëdhëniet e detyrimeve (neni 347 dhe 351), dispozita ligjore këto, në aplikim në kohën e marrjes së Vendimit të AKP.

Rregullat për parashkrimin në rastin konkret nuk mund të zbatohen sepse veprimi i vetëm i ankueses, në rastin konkret, ishte kërkesa drejtuar pranë Komitetit të Likuidimit e që afatet dhe procedura e likuidimit rregullohet me ligj të veçantë e në këtë rast me Ligjin për AKP (shtojca e ligjit) dhe se përfundimisht afatet rrjedhin nga momenti i njoftimit së procedurës së likuidimit.

Së dyti, duke u bazuar në nenin 370 të LMD Jugosllav respektivisht nenit 351 të LMD të Kosovës, Ligji për AKP – shtojca e saj, rregullon procedurën e likuidimit të një NSH si procedurën dhe mënyrën e likuidimit si dhe përmbushjen e obligimeve ndaj kreditorëve eventuale, afatet e parashtrimit të kërkesave etj.

Si ilustrim, të lartëcekurës, shih nenin 10 të Shtojcës së Ligjit për AKP ku parashihet se çdo procedurë eventuale, gjyqësore, administrative etj, ndaj një NSH e cila tani më ka hyrë në proces të Likuidimit, duhet të ndërpritet.

Përfundimisht procedura e likuidimit të një NSH, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, është e vetmja mënyrë proceduralo - ligjore lidhur me përmbushjen e obligimeve kreditorë, si ndaj punëtorëve e po ashtu edhe ndaj kreditorëve tjerë potencial (*lex specialis*).

Asnjë punëtor/e apo kreditor potencial, nuk mund ti realizoj të drejtat e tyre kreditorë ndaj një NSH, pa hapjen e procedurës së likuidimit nga ana e AKP, dhe referenca si ajo se parashtruesja nuk ka inicuar rast ligjor, konsiderohet i papranueshëm.

Në bazë të nenit 54 paragrafi 1 nenit 74 paragrafi 4 të Ligjit për DHPGJS u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **Taksa Gjyqësore:**

Ankuesi ka paguar taksat gjyqësore, në lartësi prej 30 Euro. Andaj gjykata me rastin e vendosjes si në pikën 5 të aktgjykimit, në kuptim të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, ka vendosur që ankuesit ti kompensohet kërkesa mbi taksat e paguara nga ana e tij.

Bazuar në nenin 62 të Ligjit për DHPGJS, lidhur me nenin 6.2 dhe nenin 6.1 të Rregullores për tarifën e avokatëve, datë 18 mars 2017, vendosi si në pikën 7 (shtatë) të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Andaj u vendos si në dispozitiv.



**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për DHPGJS.

---

Gazmend Sylaj, Gjyqtar